

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-400 N Elastic

VESHJE PUR ME 1 PËRBËRËS DHE ELASTICITET TË LARTË

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-400 N Elastic është veshje rrëshire poliuretani me 1 përbërës, elasticitet të lartë, përmbajtje tretësi, rezistencë ndaj rrezeve UV dhe me ngjyrë që thahet me lagështinë.

PËRDORIMET

Sikafloor®-400 N Elastic duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Sikafloor®-400 N Elastic përdoret për:

- Veshje të lëmuar ose kundër rrëshqitjes, me rezistencë ndaj rrezeve UV, kundër ndikimeve të motit, ngushtuese e plasaritjeve për betonin dhe nënshtresat prej llaçi me bazë çimentoje
- Për ekspozim mekanik të lehtë deri në mesatar
- Për ballkone, tarraca, ura këmbësorësh, shkallë, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Elasticitet i lartë
- Ngushtim i plasaritjeve
- Rezistencë ndaj ujit
- Rezistencë ndaj rrezeve UV, nuk zverdhet
- Rezistencë ndaj ndikimeve nga kushtet e motit
- Rezistencë ndaj abrazionit për përdorim normal
- Mundësi krijimi sipërfaqesh jo të rrëshqitshme

MIRATIME / STANDARDE

- Material rrëshire sintetike për llaç dysHEMEJE sipas EN 13813:2002, Deklaratë Performance 0208050100100000011008, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0921 dhe mbart markën CE
- Veshje për mbrojtjen e betonit sipas EN 1504-2:2004, Deklaratë Performance 0208050100100000011008, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 0921 dhe mbart markën CE
- Miratim për "Sistem për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë", Z-59.12-4, DIBt, Gjermani, korrik 2008.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|---|---|
| Baza kimike | PUR |
| Ambalazhi | Kovë 6 kg dhe 18 kg |
| Paraqitja / Ngjyra | Lëng me ngjyrë. Mundësi pothuajse e pakufizuar për përzgjedhje ngjyrash. |
| Jetëgjatësia | 6 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. |
| Dendësia | ~ 1.6 kg/l (DIN EN ISO 2811-1) |
| Përmbajtja e substancave të ngurta për ~ 88 % peshë | |
| Përmbajtja e substancave të ngurta për ~ 77 % vëllim | |

TË DHËNA TEKNIKE

| | | | |
|----------------------------|--|--|-------------|
| Rezistenca ndaj abrazionit | 30 mg (CS 10/1000/1000) | (8 ditë / +23°C) | (DIN 53109) |
| Zgjatimi deri në thyerje | Në +23°C | ~320 % | (DIN 53504) |
| | Në -20°C | ~70 % | |
| Rezistenca kimike | Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik. Kujdes: Vera, kafeja dhe petalet e luleve, etj. mund të shkaktojnë çngjyrosje të sipërfaqes. Kjo gjë nuk ka asnjë efekt në performancën dhe qëndrueshmërinë e produktit. Përdorni Sikafloor®-410 për mundësi të përmirësuar pastrimi dhe rezistencë ndaj kontaminimit. | | |
| Rezistenca termike | Ekspozimi* I përhershëm Afatshkurtër max. 7 ditë Afatshkurtër max. 8 orë | Nxehtësi e thatë +50°C +80°C +100°C | |
| | *Pa ekspozim të vazhdueshëm kimik dhe mekanik. | | |

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

| | | |
|----------|---|---|
| Sistemet | Ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit: | |
| | Sikafloor® MonoFlex MB-23 | Veshje përfundimtare për dysheme, prej poliuretani me 1 përbërës, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme dhe me aftësi ngushtimi të plasaritjeve |
| | Sikafloor® MonoFlex MB-24 | Veshje dekorative për dysheme, e lëmuar me 1 përbërës dhe me aftësi ngushtimi të plasaritjeve |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|--------------------------------------|--|
| Konsumimi | 0.4 - 1.5 kg/m ² /mm në varësi të aplikimit. Ju lutemi referohuni në skedën teknike të sistemit përkatës. |
| Temperatura e mjedisit | +10 °C min. / +30 °C max. |
| Lagështia relative e ajrit | 80 % max. lagëshi relative 35 % min. (nën +20 °C: 45 % min.) |
| Pika e vesës | Kujdes kondensim! Nënshtresa dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit apo çngjyrosjes mbi dyshemenë e përfunduar. |
| Temperatura e nënshtresës | +10 °C min. / +30 °C max. |
| Lagështia e përmbajtur e nënshtresës | < 4 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie. Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharjes në furrë. Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietileni). |
| Koha e punueshmërisë | Materiali në enët e hapura duhet të aplikohet menjëherë. Në enët e hapura formohet cipë sipërfaqësore brenda 1-2 orëve. Temperaturat e larta dhe lagështia atmosferike e lartë do të përshpejtojnë ndjeshëm tharjen. |

Koha e maturimit

Përpara mbiveshjes së Sikafloor®-400 N Elastic lini:

| Temperatura e nënshtresës | Min. | Max. |
|---------------------------|--------|--------|
| +10 °C | 36 orë | 5 ditë |
| +20 °C | 24 orë | 3 ditë |
| +30 °C | 16 orë | 2 ditë |

Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

| Temperatura (lagështia relative 50%) | Rezistencë ndaj shiut | Qarkullim këmbësorësh | Tharja e plotë |
|--------------------------------------|-----------------------|-----------------------|----------------|
| +10 °C | ~15 orë | ~1 - 2 ditë* | ~7 - 14 ditë* |
| +20 °C | ~5 orë | ~6 - 24 orë* | ~5 - 9 ditë* |
| +30 °C | ~3 orë | ~4 - 18 orë* | ~3 - 5 ditë* |

*Ndikohet fuqishëm nga trashësia e shtresës

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pislëqë, vaj, graso, veshje dhe trajtime të sipërfaqes, etj. Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me fshesë thithëse elektrike. Rezistenca ndaj tërheqjes nuk duhet të jetë më pak se 1.5 N/mm². Në rast dyshimi aplikoni më parë mbi një zonë për provë.

PËRZIERJA

Përpara përdorimit përzieni mekanikisht Sikafloor®-400 N Elastic për 3 minuta. Nëse kërkohet shtoni Thinner C ose Extender T dhe përzieni derisa të përftohet një përzierje e njëtrajtshme. Duhet të shmangët përzierja e tepërt për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Veglat për përzierje:

Sikafloor®-400 N Elastic duhet të përzihet plotësisht me mikser në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm) ose me pajisje tjetër të përshtatshme

APLIKIMI

Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë së nënshtresës, lagështinë relative dhe pikën e vesës. Si prajmer aplikoni Sikafloor®-400 N Elastic me furçë, rul ose shkop gome (squeegee) dhe si veshje Sikafloor®-400 N Elastic derdhet dhe përhapet në mënyrë të njëtrajtshme me mallë.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Thinner C menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia e nënshtresës & Përgatitja

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

Mirëmbajtja

Ju lutemi referohuni tek "Sikafloor® - REGJIMI I PASTRIMIT"

KUFIZIME

- Mos aplikoni Sikafloor®-400 N Elastic mbi nënshtresa me lagështi në rritje.
- Sikafloor®-400 N Elastic i sapoaplikuar duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Përpara mbiveshjes me Sikafloor®-400 N Elastic, veshjet e prajmerit duhet të jenë të thara dhe jo të ngjitshme.
- Të mos përdoret për aplikime të brendshme.
- Aplikoni gjithmonë gjatë temperaturave në rënie.
- Nëse aplikohet gjatë temperaturave në rritje mund të shfaqen "vrime" nga ajri i ngritur.
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në kohë të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.
- Për përputhje të saktë ngjyrash, sigurohuni se Sikafloor®-400 N Elastic është aplikuar në secilën zonë nga i njëjti numër serie prodhimi.
- Në kushte të caktuara, temperaturat e larta të ambientit të kombinuara me ngarkesat pikësore të mëdha, mund të lëjnë shenja në rrëshirë.
- Nëse nevojitet ngrohje, mos përdorni gaz, vaj, vajguri apo ngrohës me lëndë djegëse fosile të tjera, këto prodhojnë sasi të mëdha CO₂ dhe avujsh uji H₂O, të cilët mund të ndikojnë negativisht tek sipërfaqja përfundimtare. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / i lloji sb) është 500 g/l (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e lejuar e Sikafloor®-400 N Elastic është < 500 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-400 N Elastic
Prill 2019, Botimi 02.01
020812020020000001

Sikafloor-400NElastic-sq-AL-(04-2019)-2-1.pdf

